

Konsultime nacionale me të rinjtë mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së

Selcë, Kroaci

3 dhjetor 2009

Konsultimet nacionale me të rinjtë në Kroaci i kanë organizuar Rrjeti i të Rinjve të Kroacisë dhe OJQ Documenta nga Zagrebi, me 46 pjesëmarrës. Ligjërues ishin Eugen Jakovčić (Documenta, Zagreb, Kroaci) dhe Ivan Novosel (Legalis, Zagreb, Kroaci). Takimin e moderoi Emina Bužinkić (Rrjeti i të Rinjve në Kroaci, Zagreb, Kroaci).

Shqyrtimi i propozimeve, rekomandimet dhe opinionet e pjesëmarrësve/eve:

Rritja e mobilizimit të të rinjve, bashkëpunimi ndërkulturor, prodhimi i filmave për ballafaqimin dhe përfshirja e medieve do të duhej të jetë bazë për hartimin e politikave për të rinjtë.

Mendoj se gjeneratat tona në mënyrë indirekte, gjithashtu janë viktima. (...) Gjasat tona janë dukshëm më të vogla, krahasuar me bashkë-moshatarët tanë nëpër Evropë dhe botë... Ajo, se si mund ta shoh formimin e politikave të të rinjve, përpos rëndësisë së edukimit formal dhe joformal, që është absolutisht gjëja e parë, po aq i rëndësishëm është edhe mobilizimi, mobilizimi rajonal i të rinjve. Dhe, çështja tjetër me rëndësi është roli i medieve dhe prodhimi i produksioneve të pavarura dokumentare. Të gjithë kemi parë se sa shumë mund të bëjnë filmat si ata: „Stuhia mbi Krainë“; „Vukovar – prerja e fundit“; dhe „Të shlyerit“ , se çfarë ishin ato bomba të cilat shpërthyen në shoqëritë tona. Absolutisht ka nevojë për më shumë kësi filma, dhe do të duhej të shfaqen në televizione në terminet e shikueshmërisë më të madhe. (...) Dua të them se është shumë e rëndësishme, në shoqëritë tona, pra në nivel kombëtar të propozojë të fillojë bashkëpunimi ndërkulturorë në nivel rajonal, dhe të përqendrohet në bashkëpunimin e të rinjve në fushën e zhvillimit të përbashkët të ngjarjeve kulturore. (Katarina Pavić, Rrjeti i të Rinjve në Kroaci, Zagreb, Kroaci, Konsultime nacionale me të rinjtë mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Selcë, Kroaci, 3 Dhjetor 2009)

Të rinjtë do të duhej të kërkojnë nga Qeveria e Kroacisë që t'u hiqen nga librat shkollorë përmbajtjet e miteve dhe të futen në to sa më shumë fakte.

(...) Bëhen shumë përpjekje, për shembull në Gjermani, Poloni, e Francë në zhvillimin e librave shkollorë nga të cilët tentohet të hiqen interpretimet mitike të konflikteve, dhe të futen sa më shumë fakte. Mund të jetë njëra nga kërkesat tona për Qeverinë e Republikës së Kroacisë, që të

shkohet në këtë drejtim? (...) Ndoshta do të ishte sugjerim i mirë nëse qeverive tona u drejtohet apeli për themelimin e një Komisioni të tillë Rajonal. Ndoshta kjo do të mund të ishte një iniciativë avokimi e organizatave të të rinjve. Nuk e di, si po ju duket juve? A ta radhisim në këto rekomandime të cilat do t'ia dërgojmë Qeverisë së Republikës së Kroacisë, që seriozisht të mendojë për themelimin e një komisioni të tillë/ (...) Rrjeti i të Rinjve të Kroacisë do të inkuadrohet përmes aktiviteteve të Bordit drejtues dhe ekipit operativ në mbledhjen e nënshkrimeve dhe në mbështetjen e iniciativave të ndryshme lokale. (Emina Bužinkić, Rrjeti i të Rinjve në Kroaci, Zagreb, Kroaci, Konsultime nacionale me të rinjtë mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Selcë, Kroaci, 3 Dhjetor 2009)

Sistemi i arsimit duhet të punojë afatgjatë në ndërtimin e paqes, së pari përmes librave shkollorë, historisë, sociologjisë... më shumë fakteve, më pak interpretimeve. Të rinjtë duhet t'u mësohen shkathtësitë se si të ballafaqohen me situatat e ndryshme ndër-kulturore.

Besojmë se sistemi arsimor është diçka ku mund të punohet në mënyrë afat-gjate në ndërtimin e paqes në shoqërinë tonë. (...) Së pari në librat e historisë, sociologjisë dhe lëndëve tjera shkollore, është me rëndësi të mos ketë interpretime të ngjyrosura. Gjegjesisht, të mos merren me interpretimin e të dhënave, por do të ishte më mirë për shoqërinë tonë, që në to të ketë më shumë fakte dhe ndoshta interpretimet t'u lihen të rinjve. Pra, të kemi, për shembull, ti kemi të radhitura: në atë vend kanë vdekur kaq civilë, ajo ushtri ka qenë atje, e kështu me radhë, të kemi faktet. Aq sa jam i informuar, ne akoma nuk i kemi të dhënat e sakta. (...) Gjithashtu, është me rëndësi të mësohen shkathtësi të ndryshme, e jo veç të fitohen njohuri të reja lidhur me ndërtimin e paqes. Pra, shkathtësi me të cilat të rinjtë do të aftësohen të ballafaqohen me situatat në të cilat do të gjenden. Dhe në raportin e tyre me të kaluarën, dhe në qëndrimin kritik si dhe të menduarit për atë se çka ka ndodhur. Çfarë mund të mësojmë nga kjo, apo si të ballafaqohemi, nuk e di, në ndonjë situatë ndër-kulturore dhe me të rinjtë e vendeve tjera, nga shtetet të cilat në një kohë të caktuar i kemi konsideruar armiq, ose të paktën ashtu janë prezantuar. Apo ishin, gjithsesi. (Lovorka Bačić, Qendra për Studime të Paqes, Zagreb, Kroaci, Konsultime nacionale me të rinjtë mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Selcë, Kroaci, 3 Dhjetor 2009)

A është e mundur që viktimat të vinë në shkollë dhe të flasin për përjetimet e tyre? Do të duhej të dëgjoen edhe dhunuesit, të cilët fshihen pas viktimave. Ata duhet dëgjuar, për të parë se deri ku mund të shkojë njeriu.

... Ekziston shkuarja në Jasenovc, njerëzit shkojnë në organizime grupore në vende të tilla. Atëherë, a ka kuptim, pasi që Documenta punon në ballafaqimin dhe dëshminë e viktimave, atëherë a është e mundur që disa viktimat të vinë në shkollë apo vende tjera dhe të flasin për përvojat e tyre, Por, për mua do të ishte më interesante ta dëgjojmë dhunuesin, e jo viktimën.

Mendoj, se viktimat gjithnjë tingëllojnë ngjashëm, më interesante është që disa ushtarë që ecin përreth, të flasin për atë se çka kanë bërë dhe si e kanë bërë, etj. Pra, që ata të rinj të shohin se çka do të thotë ajo. Në përgjithësi, ideja për atë se si ndihet njeriu i cili vret njeriun. (...) Dhunuesit janë ata të cilët janë fshehur pas viktimave, e të rinjtë natyrisht se mund të jenë të dhunshëm. (...) Kështu që, ky është një shkas te të gjithë ne, te të gjithë të rinjtë, kështu që ndoshta do të ishte më mirë të shohim se çfarë është me vetë dhunuesit. Ti dëgjojmë edhe vëzhguesit, e dini se çfarë kanë qenë vëzhguesit në luftë, ata të cilët i kanë prerë veshët, hundët, etj. Dhe kjo është ajo fascinuesja, se deri ku mund të shkojë njeriu. (Marina Globočnik, FadeIn, Zagreb, Kroaci, Konsultime nacionale me të rinjtë mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Selcë, Kroaci, 3 Dhjetor 2009)

Është shumë me rëndësi t'u mësohet fëmijëve dhe të rinjve për gjërat e përbashkëta të cilat i kemi pasë para viteve të nëntëdhjeta, dhe si ka ardhur deri të ngjarjet (luftërat) e tilla.

... Në shkolla ka sasi të madhe të mitologjisë. Mirëpo, përpos kësaj, lëmisë e cila merret me luftërat, shkatërrimin e ish shteteve dhe krimet e kryera, është shumë e rëndësishme që fëmijëve t'u mësohet (rrëfëhet) për gjërat e përbashkëta të cilat i kemi pasë para vitit 1990. Kjo është një periudhë, e cila madje as nuk është interpretuar në librat shkollorë të historisë, për këtë temë janë një apo dy faqe. Kështu që, mendoj se ky segment është gjithsesi shumë i rëndësishëm. Pra, edukimi në lëminë e historisë, sepse kjo tani po hyn në atë që ka qenë më parë, se si në fakt ka ardhë deri të gjërat e tilla. (...) Përmes njërive formale për shkak të rrëfimeve të tyre shoqërore dhe kulturore. Këtu është shumë e vështirë të arrihet objektiviteti, madje edhe në vetë tekstin, sepse e dimë se ky është një proces i sub-koshiencës të formimit të vetëdijesimit klasor, nacional (kombëtar) dhe racor. (...) Ata të cilët edukojnë (mësimdhënësit) do të duhej të arrijnë në një nivel të objektivitetit, sikurse edhe komuniteti dhe prindërit. Pra, procesi në përgjithësi. (Marija Hrebac, Rrjeti i të Rinjve në Kroaci, Zagreb, Kroaci, Konsultime nacionale me të rinjtë mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Selcë, Kroaci, 3 Dhjetor 2009)

Nuk e përkrahi sjelljen e dhunuesve dhe viktimave, në shkollë. Kemi më shumë punë rreth ballafaqimit me të tashmen.

Unë nuk do t'ia lejoj fëmijës tim ballafaqimin, dhe do të isha kundër nëse dikush do të sillte viktimën apo dhunuesin në shkollë. Dhe nuk e mbështes këtë. Mendoj se kemi shumë më shumë punë rreth ballafaqimit me të vërtetën, rreth hapjes së syve, parasegjithash të syve tonë, rreth asaj se çfarë po ndodhë rreth nesh. (Vesna Vilus, Vendor, Karlovc, Kroaci, Konsultime nacionale me të rinjtë mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Selcë, Kroaci, 3 Dhjetor 2009)

Nëpër shkolla dhe fakultete, në tërë Kroacinë, të vendosen pultet e informimit për KOMRA-në, dhe të organizohen ligjërata.

... Më i rëndësishmi është rekomandimi që nëpër shkolla dhe fakultete, nëpër tërë Kroacinë të vendosen pultet e (tavolinat) informimit, në të cilat do të informoheshin të rinjtë për KOMRA-në, por gjithashtu edhe të organizohen ligjërata të shkurtra përmes të cilave do të mund të mësonin më shumë për KOMRA-në. Kolegët nga Shoqata Feriale Hotelierike në Kroaci, i kanë ofruar vullnetarët e tyre, që janë numerikisht mjaft shumë, rreth dyqind, që të angazhohen rreth mbledhjes së nënshkrimeve. (...) Të vendosen pultet (tavolinat) e informimit nëpër hotele në kuadër të Shoqatës Feriale në Kroaci, saktësisht në gjashtë sosh, ku të rinjtë e Kroacisë, por edhe të tjerët, do të mund të informohen lidhur me këtë temë. (...) Kolegu nga shoqata K.V.A.R.K. nga Krizhevacë, ka thënë se shoqata e tyre do të mund të angazhohet në mbledhjen e nënshkrimeve dhe në organizimin e punëtorive në të cilat do të diskutohej për KOMRA-në dhe ku do të shfaqeshin filmat. (Darija Marić, Documenta, Zagreb, Kroaci, Konsultime nacionale me të rinjtë mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Selcë, Kroaci, 3 Dhjetor 2009)